

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 575 Prot.

Tiranë, më 03.06 2016

VENDIM Nr. 33, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Amantia"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Dr. Elio Hobdari,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Amantia"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Dr. Elio Hobdari, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Kërkim sipërfaqësor (survey) në zonën e nekropolit
 - Pastrim i përgjithshëm i varrit 3 në Nekropolin Verilindor
 - Rilevim topografik i sipërfaqes që përfshin stadiumin dhe ndërtimet përreth tij dhe Nekropolin Verilindor."
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë, në varësi të financimit dhe angazhimeve të tjera të paparashikuara të stafit, në periudhën fund maji fillim qershori ose në muajin shtator të vitit 2016. Për datat e sakta ose për zhvendosje të periudhës kohore, do të njoftohet sekretaria e KKA.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

